



Grupi i Punës IV
Sesioni II “Ndotja e Mjedisit në Shqipëri dhe Standardet Europiane”

7 tetor 2015, 11:00 – 13:00

Situata aktuale

Të dhënat mbi gjendjen aktuale të mjedisit janë marrë kryesisht nga Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2014 hartuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) si dhe nga disa studime të posaçme për gjendjen e elementëve të mjedisit në Shqipëri. Vëmendja e grupit të punës u përqëndrua kryesisht në diskutimin e çështjeve më urgjente të ndotjes, si ndotja e ajrit, ujrave, tokës dhe në problemin e menaxhimit të mbetjeve një nga sektorët kryesorë që ndikon në ndotjen e mjedisit në Shqipëri.

Raporti 2014 i AKM-së, ofron disa të dhëna të pjesshme në lidhje me gjendjen e ndotjes së Ajrit në Shqipëri. Kjo për arsye se, siç përcaktohet në raport **“rrjeti ekzistues i monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri është i kufizuar në aspektin e numrit të stacioneve monitoruese po ashtu edhe në tipin e stacioneve”**. Si rrjedhojë monitorimi është kryer vetëm në disa stacione të disa qyteteve kryesore të Shqipërisë dhe përkatësisht në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë, Berat, Fier dhe Kukës.

Arsyeja e realizimit të aktivitetit në Elbasan qëndron në faktin që në këtë qytet rezultojnë nivelet më të larta të ndotjeve pasi: (i) Metalurgjiku i Elbasanit dhe industria e mineraleve janë ndotësit kryesor me hekur, krom, nikel dhe vanadium. (ii) ka përqëndrime të larta të plumbit mbi nivelin e lejuar në Elbasan. Po ashtu, **ndotja e tokës nga metalet e rënda** është një problem shqetësues për Shqipërinë duke qënë se ka aftësinë të ndikojë seriozisht në shëndetin e njeriut nëpërmjet zinxhirit ushqimor të rritur dhe të ushqyr në tokat e ndotura. Mungesa e informacionit mbi shkallën e ndotjes së tokës nga metalet e rënda shpesh ka çuar në përdorime të pa përshtatshme të tokës me pasoja në shëndetin e njerëzve si përshembull përdorimi i tokës për kultivimin e bimëve të arave.

Shkarkimet urbane të ujrave të patrajtuara kanë një ndikim të dukshëm edhe në cilësinë e ujërave detare. Përshembull është vënë re se mos funksionimi i impianteve të trajtimit të ujrave urbane në Vlorë dhe Sarandë ka shkaktuar ndotje dhe përkeqësimin e cilësisë së ujërave detare të larjes. Veçanërisht gjatë muajit Gusht është vënë re shtimi i bakterit E. Coli fekal dhe streptokoku fekal (IE) muajit Gusht. Ndotje e konsiderueshme e ujrave .

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është i decentralizuar, pra kryhet nga organet përkatëse të pushtetit vendor të cilat kryesisht kontraktajnë shoqëri private për kryerjen e shërbimeve të mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve. Kjo praktikë zbatohet kryesisht në qytetet e mëdha ndërsa zonat rurale nuk janë ende të mbuluara nga shërbimi i menaxhimit të mbetjeve. Në këto zona pjesa më e madhe e mbetjeve depozitohen në lumenj ose në anë të rrugëve duke shkaktuar ndotjen e tokës dhe ujrave. Sistemi i riciklimit të mbetjeve në Shqipëri është ende në fazën fillestare. Nuk ka një sistem të sigurtë për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, siç janë mbetjet industriale, shtëpiake dhe spitalore. Metoda më e përdorur për trajtimin e mbetjeve është ajo e groposjes, por gropat e përdorura për këtë qëllim nuk



kanë strukturën e përshtatshme ose janë vendosur në zona të ndjeshme të cilat çojnë në ndotjen e mjedisit.

Legjislacioni i BE-së dhe ai shqiptar për mbrojtjen e mjedisit

Mjedisi është ndër-territorial, pra i kalon kufijtë e një vendi dhe për këtë arsye Bashkimi Evropian i jep një rëndësi të veçantë mbrojtjes së tij. Prej vitesh BE-ja ka miratuar një sërë Direktivash dhe Rregulloresh të cilat përcaktojnë standarde të rrepta për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të ndikojnë në ndotjen e mjedisit. Eksperti i Grupit të Punës nënvizoi rëndësinë e legjislacionit dhe standardeve të BE-së në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke analizuar veçanërisht dy direktiva kyçe për mbrojtjen e Mjedisit :

- Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e cila sjell disa risi, si regjimin e përgjegjësisë edhe pa faj për ndotësit që kryejnë aktivitete me rrezikshmëri për mjedisin dhe mundësimin e grupeve të interesit dhe OJF-ve mjedisore t’i kërkojnë autoriteteve publike të **veprojnë** në raste ndotje dhe t’i drejtohen gjykatës në rast se konsiderojnë që veprimi apo mosveprimi i autoriteteve është i paligjshëm.
- Direktivën 2008/99/EC “Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal” e cila përbën një hap thelbësor në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet legjislacionit evropian duke qënë se për herë të parë u kërkohej shprehimisht shteteve antare mbrojtja e mjedisit, nga disa lloje të rënda ndotje, me anë të legjislacionit penal.

Eksperti i Grupit të Punës vuri në dukje se disa elemente të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit janë të përafuara me standartet evropiane. U përmend si shembull ligji kuadër nr. 10431 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE mbi përgjegjësinë mjedisore, të përmendur më sipër dhe përmban disa nga parimet e kësaj direktive si parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, parimin e zëvendësimit dhe kompensimit, parimin ndotësi paguan etj. Gjithashtu ligji 10431, ashu si Direktiva 2004/35/KE parashikon edhe mundësinë që publiku ti kërkojë autoriteteve marrjen e masave në rast kërcënimi apo ndotje të mjedisit. U përmend edhe fakti që Kodi Penal shqiptar parashikon disa vepra penale si krime mjedisore. Si shembull u morën: Neni 201 i KP i cili dënon ndotjen e ajrit me gjobë ose burgim deri në 2 vjet dhe deri në 10 vjet kur ka pasoja të rënda për jetën apo shëndetin dhe Neni 203 i cili dënon ndotjen e ujrave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera nga 1-5 vjet dhe nga 5 deri në 10 vjet për pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin.



Probleme dhe Rekomandime

➤ **Ndotja**

Eksperti i Grupit të Punës vuri në dukje se shpjegimi i rezultateve teknike të monitorimit të mjedisit të përmbajtura në Raportin 2014 të AKM-së nuk është shumë i detajuar dhe i kuptueshëm për publikun pasi shifrat e ndotjes nuk përkthehen në shpjegime të qarta mbi pasojat dhe rrezikun që sjell niveli i identifikuar i ndotjes në mjedis dhe në shëndetin e njeriut. Është e nevojshme që Shqipëria të nisë të kryejë **monitorime të plota dhe gjithpërfshirëse** nëpërmjet teknologjisë dhe burimeve njerëzore të përshtatshme për gjendjen e ndotjes së të gjitha elementeve të mjedisit. Monitorimet duhet të rezultojnë në grumbullimin e statistikave të plota për çdo pjesë të territorit. Rezultatet e mbledhura duhet të shpjegojnë në mënyrë të qartë për publikun e gjerë situatën e ndotjes së mjedisit dhe rrezikshmërinë që kjo paraqet për shëndetin e tyre sidomos pranë zonave të banuara.

Si problem kyç u përmend edhe menaxhimi i mbetjeve. Grupi i Punës theksoi se nuk ka një sistem mirëmenaxhimi të mbetjeve, duke përmendur se teknika më e përdorur e groposjes ka mangësira të konsiderueshme pasi realizohet në thellësi jo të madhe duke shkaktuar një rrezik të lartë për ndotjen e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve. Në mënyrë urgjente duhet të ngrihet dhe të vendoset në funksion **një sistem i përshtatshëm i menaxhimit të mbetjeve** për të shmangur ndotjen e mëtejshme masive nga ky fenomen. Autoritetet publike, secila në bazë të kompetencave të tyre duhet të angazhohen sa më shpejt për të marrë masat e nevojshme të parandalimit të ndotjes së mëtejshme dhe sidomos për të bonifikuar zonat e evidentuara si të ndotura, veçanërisht ato zona të cilat përdoren edhe si toka bujqësore dhe paraqesin një rrezikshmëri direkte për shëndetin e njeriut.

➤ **Zbatimi i Legjislacionit**

Grupi i Punës theksoi se problemi kryesor qëndron jo aq në mangësitë e legjislacionit shqiptar sesa në mungesën e zbatimit të legjislacionit ekzistues. U përmend fakti që shpesh ka mangësi në miratimin e akteve nënligjore zbatuese, si dhe realizimi i VNM-ve lë për të dëshiruar dhe në të shumtën e rasteve realizohen nga një specialist i vetëm edhe për projekte të komplikuar. Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e mjedisit duhet të vazhdojë me shpejtësi përafrimin me legjislacionin evropian veçanërisht për sa i përket ligjeve sektoriale për mbrojtjen e elementeve të mjedisit. Gjithashtu i gjithë legjislacioni mjedisor duhet të harmonizohet në mënyrë që të mos ketë boshllëqe dhe mbivendosje kompetencash. Kjo do të arrihej në mënyrë optimale nëpërmjet **hartimit të një kodi mjedisor** i cili të rregullojë në mënyrë të harmonizuar të gjithë sektorin.

Gjithashtu sipas pjesmarrësve të Grupit të Punës procedura e dhënies së lejeve mjedisore është jo-transparente. Duhet zgjidhur **problemi i lëshimit të lejeve mjedisore** duke e bërë procesin vërtetë



transparent dhe problemi i hartimit të VNM-ve duke përcaktuar si kusht se për projektet e komplikuara nevojitet bashkëpunimi i disa ekspertëve mjedisor të cilët mbulojnë aspekte specifike të projektit.

Një vështirësi tjetër në zbatimin e legjislacionit e vënë në dukje nga përfaqësuesit e inspektoriatit të mjedisit është fakti se niveli i gjobave për shkeljet mjedisore rezultojnë të jetë shumë të larta dhe i papërbalueshëm për biznesin e vogël. Ndërsa në kuadrin e vështirësive praktike u evidentua fakti se për shkak të komuniteteve të vogla ku operojnë sëbashku bizneset dhe inspektorët dhe njohjeve reciproke vendosja e gjobave rezultojnë të vështirë veçanërisht në rastet kur gjobat e vendosura nga inspektorët në terren anulohen më pas në instancat më të larta administrative. Duhet së pari **vullneti i qartë i autoriteteve publike** për të kapërcyer problemet praktike të zbatimit të legjislacionit si ato të njohjeve personale me bizneset e gjobitura të përmendura më sipër, presionet apo korrupsioni.

➤ **Kapaciteti institucional dhe përvetësimi i granteve të BE-së për mjedisin**

Megjithëse BE-ja ka qënë e gatshme të vendosë në dispozicion grante të konsiderueshme për të ndihmuar vendet kandidatë për antarësim t'u afrohen standarteve evropiane në mbrojtjen e mjedisit thithja e këtyre granteve nuk është automatike. Kështu u vu në dukje nga Grupi i Punës fakti se vetë pushteti vendor nuk ka kapacitetet e duhura të burimeve njerëzore për të hartuar projekt-propozime të përshtatshme për thithjen e granteve të BE-së. Pengesë në marrjen e ndihmave financiare/granteve nga BE-ja për fushën mjedisore është edhe mungesa e theksuar e studimeve në nivel mikro dhe e statistikave të qarta për gjendjen e ndotjes së mjedisit në Shqipëri. Gjithashtu u vu në dukje se mbas lëvrimit të granteve ka vështirësi në zbatimin e projekteve për shkak të mangësive strukturale dhe të burimeve njerëzore në fushën e mjedisit, pengesa të cilat mund të sjellin dështimin e zbatimit të projekteve mjedisore dhe detyrimin e kthimit të ndihmave financiare të marra nga BE-ja.

U vu në dukje se mungon koordinimi ndërmjet insitucioneve të ndryshme kompetente për mbrojtjen e mjedisit midis të cilave ka mbivendosje përgjegjësish dhe konflikte kompetencasht si dhe mungojnë mekanizmat administrative dhe procedurale për zbatimin e legjislacionit. Hap tjetër i domosdoshëm është **qartësimi i kompetencave të institucioneve të ndryshme zbatuese të legjislacionit mjedisor si dhe kompetencave ndër-insitucionale**. Nevojitet një **forcim i bashkëpunimit ndërinsitucional** si dhe koordinim më efikas brenda një institucioni.

Në kuadër të hapave për antarësim në BE, Shqipëria e ka të domosdoshme të forcojë kapacitetet e saj në mbrojtjen e mjedisit duke vënë në dispozicion burime teknologjike, njerëzore dhe financiare të përshtatshme. E domosdoshme është edhe **forcimi i kapaciteteve të njësive vendore** të cilat kanë kompetenca të monitorimit dhe mbrotjejs së mjedisit. Organet zbatuese të legjislacionit mjedisor duhen fuqizuar duke u dhënë së pari pavarësi institucionale nga presionet apo ndërhyrjet e jashtme dhe mbështetje nga organet e qeverisjes qendrore në ushtrimin e funksioneve të tyre.



Është i nevojshëm **rindërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit** në të cilin jetojnë nëpërmjet fushatave sensibilizuese. Edukimi mjedisor mund të kryhet më mirë nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë midis qeverisë, organizatave jo-fitimprurëse, akademisë, medias, shoqërisë civile, sistemit të edukimit dhe qytetarëve në përgjithësi. Grupi i Punës sugjeroi që me anë të fushatave inovative informuese, ndërgjegjësuese dhe përfshirëse qytetarët të nxiten në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit ku banojnë. Ruajtja e mjedisit duhet të konsiderohet si e një e drejtë njeriu që u përket të gjithë komunitetit të interesuar. Shumë i dobishëm do të ishte **bashkëpunimi me institucionet arsimore**, si psh 1. Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore për ofrimin e programeve të edukimit mjedisore sa më cilësore, të pasura me trajnime e aktivitete për nxënësit; 2. Marrëveshje bashkëpunimi me Fakultete Juridike e Ekonomike për një fokus më të madh të të drejtës mjedisore dhe impaktit ekonomik që shkakton ndotja e mjedisit.

Pjesëmarrës në Sesionin I, Grupin e Punës: Institucione shtetërore dhe shoqëri civile

Institucione shtetërore :

Agjensia Rajonale Mjedisore, Elbasan

Edmond Xhufka

Flladi Pengu

Olger Dhima

Elis Duzha

Pellumb Ahmeti

Gentian Sllami

Jani Ranxha

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit

Besnik Mulaj

Ada Guzi

Shoqëri Civile :

Sazan Guri - GG Group

Eralda Hoxhaj- ETMI

Herda Pacco -Qendra EDEN

Genci Haxhi- ALBAFOREST

Arian Cala-Tjeter Vizion Elbasan

Leonard Tefa-KURUM

Nertila Toli- Forumi i Gruas, Elb

Akademia- Eriada Cela-Universiteti Aleksandër Xhuvani

Media:

Arnel Bega, Vladimir Mema Best Channel

Edlira Xherri, Julian Hoxhaj Tv Skampa